



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Komuna e Prishtinës**  
**Pristina Obstina-Municipality of Pristina**



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Albi Company” Sh.P.K. të datës 09.08.2023 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit të datës 31.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i tribunës lindore për stadiumin 2 Korriku – Faza II” me nr. të prokurimit 616-23-8041-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **APROVOHET** pjesërisht kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Albi Company” Sh.P.K. e datës 09.08.2023 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit të datës 31.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i tribunës lindore për stadiumin 2 Korriku – Faza II” me nr. të prokurimit 616-23-8041-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “Albi Company” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

## Arsyetim

Operatori ekonomik "Albi Company" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 09.08.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit të datës 31.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i tribunës lindore për stadiumin 2 Korriku - Faza II" me nr. të prokurimit 616-23-8041-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës. Pretendimet e parashtruesit janë se disa nga kërkesat e dosjes së tenderit duhet të ndryshohen pasi që si të tilla (sipas parashtruesit) ato janë në kundërshtim me parimin për mos diskriminim/favorizim në kuptim të nenit 7 të LPP. Duke u referuar te pretendimet e tij ankimore, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 1, 6, 7 dhe 69 të LPP si dhe nenin 70 të RRPP.

Konkretisht pretendimet ankimore të parashtruesit janë formuluar si në vijim:

- **Pika ankimore nr. 1** – *"Ne kërkesën 2 tek pika D) keni kërkuar Nje inxhinier te makinerisë -5 vite përvojë pune 5/3 F02 Formulari Standard per rishqyrtim te vendimit ne AK pas diplomimit. Duke u bazuar ne paramasen dhe parallogarine nuk gjindet ndonjë pozicione te punëve te makinerisë. Andaj kërkojmë qe te eliminohet"*.
- **Pika ankimore nr. 2** – *"Ndërsa sa i përket pikës E AK ka vendosur kriterin për inxhinier gjeoteknik për arsye se tek punët e betonit dhe armirimit lidhen me me inxhinierin gjeoteknik i cili ka detyrat si në vijim (Strukturat mbajtese te dheut dhe mbrojtese,te gjitha llojet e themeleve, me pilota, pllake, tip plint, ne toke). Nuk pajtohem me pergjigjen e Ak-se pasiqe Punet e betonit te cilet jane parashikuar ne paramase per ekzekutim jane qe menaxhohen nga ana e Inxhinieri I Ndertimtarise Konstruktive, ose nga inxhinieri I Arkitektures ne asnje pozicion nuk egziston betonimi I Pilotave etj. Andaj kerkojme qe te eliminohet si kerkese Mjafton Inxhinieri I Ndertimtarise drejtimi konstruktive per realizimin e ketyre puneve"*.
- **Pika ankimore nr. 3** – *"Ne kerkesen 3 tek pika B) keni kerkuar dy llamarin punes dhe punues metali te kualifikuar nga shkollat e emesme profesionale me titull Teknik. Duke u bazuar ne paramasen dhe 6/3 F02 Formulari Standard per rishqyrtim te vendimit ne AK parallogarine nuk ngjindet ndonje pozicione te puneve te llamarinese dhe metalit. Andaj kerkojme qe te eliminohet"*.
- **Pika ankimore nr. 4** – *"Ne kerkesen 3 tek pika C) keni kerkuar Nje teknik I elektroteknikes I rajnuar nga ndonje institucion shtererore apo organizate publike per instalime teknike. Në kërkesën 3 tek pika C) Ak vendosur kriter të elektro teknikës që të jetë i trajnuar nga ndonjë institucion shtetëror apo organizatë publike që përfshin edhe trajnimet nga ndonjë organizatë e licencuar edhe private që lëshojnë certifikata konform legjislacionit në fuqi. Per ju si AK me te rendesishme jane trajnimet se sa titulli teknik I shkolles mesme ku ne asnje rrethane ne LPP dhe Rregullore dhe UOPP nuk parashihet qe te kerkohen stafi teknike-mjeshtret me certifikata. Ju si AK jeni duke diskriminuar OE qe te cilet posedojne mjeshter me pervoje pune ku paguahen kontributet dhe tatimet. Kerkojme qe te eliminohet si kerkese"*.

- **Pika ankimore nr. 5** – *“Kërkesa 4 tek pika A) Se paku nje nga anataret e stafit te jete I trajnuar per saldim sipas ISO 9606-1 eshte ne kundershkrim me LPP pasiqe nuk lejohet qertifikatat e tilla qe te kerkohen pasiqe eshte ne kundershkrim me LPP dhe RRUPP. Gjithashtu ne paramase dhe paralogari nuk ka punet metalike qe eshte teper e nevojshme qe kerkohet nje gje e tille. 7/3 F02 Formulari Standard per rishqyrtim te vendimit ne AK Ne asnje rrethane nuk parashihet ne Rregullore te prokurimit dhe as ne UOPP qe mjeshtret te psoedojne certifikata trajnimi apo certifikata ISO te ndryshme si punetore. Ju si AK jeni duke diskriminuar OE qe te cilet posedojne mjeshter me pervoje pune ku paguahen kontributet dhe tatimet. Kerkojme te eliminohet si kerkese”.*
- **Pika ankimore nr. 6** – *“Kërkesa 4 pika b) AK ka vendosur kriter pasi që për vendosjen e pllakave në stadium pasi që kjo lidhet me punët e betonit dhe punët e armirimit në paramasë. Eshte kerkese e pa bazuar ne punet qe dote realizohet. Ne asnje rrethane nuk parashihet ne Rregullore te prokurimit dhe as ne UOPP qe mjeshtret te psoedojne certifikata trajnimi apo certifikata ISO te ndryshme si punetore. Ju si AK jeni duke diskriminuar OE qe te cilet posedojne mjeshter me pervoje pune ku paguahen kontributet dhe tatimet. Po ashtu nuk ka pune per shtrimin e pllakave”.*
- **Pika ankimore nr. 7** – *“Kërkesa 4 pika c) Ak ka vendosur kriter pasi që në paramasë tek punët përgatitore lidhet në tërësi puna me automjet KРАН vinç për vendosjen e kontenierëve. Nuk eshte pune qe mund te egzekutohet vetem me automjetin kran vinc pasiqe I njeiti kontinier mund te vendoset edhe me kamion vinc andaj eshte e pa arsyeshme dhe pa nevojshme kerkese e tille. Kondinieri sjellet ne fillim edhe largimi pas perfundimit te puneve te kontrates. Kontrinjeri mund te sjellet dhe vendoset edhe nga shoferi I kamionit me vinc”.*
- **Pika ankimore nr. 8** – *“Kërkesa 6. Raporti i vlerësimit të riskut kërkohet për të gjithë OE të cilët duhet të sjellin edhe kontratën me kompaninë e licencuar për arsye se e njëjta vërteton se vlerësimi i riskut është bërë mbi marrëveshjen kontraktuale sipas legjislacionit në fuqi. Kontrata mund të konsiderohet edhe sekret ndermjet paleve, Nese kompania dorezon raportin e vleresimit dhe dorezon certifikaten e kompanise te cilen e ka pergatite raportin e vleresimit te riskut atehere nese ju si AK-se konsideroni se mund te jete dokument I rrejshme atehere mund te verifikohet. Andaj kerkesa qe dorezohet kontratra me ndermjet OE dhe kompanise qe ka pergatit raportin e vleresimit te riskut eshte pa arsyeshme e pa logjishme pa bazuar me ligj”.*

Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 15.08.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

Fillimisht duhet cekur që sipas pretendimeve ankimore kërkohet që të ndryshohen ose largohen shumica e kërkesave të dosjes së tenderit lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional. Pra nuk bëhet fjalë për një kërkesë të caktuar ose dy ose tri por bëhet fjalë për shumicën e kërkesave lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional.

Përmes nenit 60 paragrafit 60.3 nënparagrafi f) të RRPP përcaktohet se kërkesa për rishqyrtim ndër të tjera duhet edhe të *“përshkruan rrethanat faktike që përbëjnë apo prodhojnë shkeljen e pretenduar”*. Në rastin konkret parashtruesi nuk ka arritur që të përshkruaj rrethanat faktike që përbëjnë apo prodhojnë shkeljen e pretenduar. Rrjedhimisht është gjetur se kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit nuk është në përputhje me nenin 60

paragrafin 60.3 nënparagrafin f) të RRPP. Kjo për arsye se formulimet e parashtruesit në shumicën e rasteve nuk janë as të kuptueshme në aspektin gjuhësor dhe as të logjikshme në aspektin juridik. Pavarësisht këtij fakti, lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit zyrtari përgjegjës i prokurimit ka kërkuar nga njësia kërkuuese që të rivlerësojë nëse kërkesat në dosjen e tenderit janë në përputhje me LPP. Rrjedhimisht me njësia kërkuuese është përgjigjur ashtu që nuk ka gjetur mospërputhje mes kërkesave të dosjes së tenderit dhe LPP me arsyetimin si në vijim:

*Për pikën ankimore 2 dhe pikën ankimore 6 – Autoriteti Publik së bashku në koordinim me Njësinë e kërkesës pas analizimit të detajuar të kriterëve kanë vendosur që të largojnë dhe ndryshojnë kriteret sipas pretendimeve në pikën 2 dhe pikën 6.*

*Pika 6 ankimore (Kërkesa 4 pika b) AK ka vendosur kriter pasi që për vendosjen e pllakave në stadium pasi që kjo lidhet me punët e betonit dhe punët e armirimit në paramasë. Është kërkesë e pa bazuar në punët që do të realizohet. Në asnjë rrethane nuk parashihet në Rregullore të prokurimit dhe as në UOPP që mjeshtret të posedojnë certifikata trajnimi apo certifikata ISO të ndryshme si punëtorë. Ju si AK jeni duke diskriminuar OE që të cilët posedojnë mjeshtër me përvojë pune ku paguhen kontributet dhe tatimet. Po ashtu nuk ka pune për shtrimin e pllakave”. Ndryshimet janë bërë duke i larguar certifikatat ISO.*

Për Autoritetin Kontraktues është e domosdoshme që ky aktivitet i prokurimit të realizohet me sukses ashtu që projekti të implemetohet në mënyrë profesionale, me cilësi të lartë dhe në përputhje me standardet e fundit ndërkombëtare.

Në rastin konkret parashtruesi ka pretenduar që kërkesat janë në kundërshtim me parimin për mos diskriminim/favorizim në kuptim të nenit 7 të LPP. Në këtë rast parashtruesi është dashur që krahas pretendimeve të paraqet edhe argumentet e tij se këto kërkesa është vështirë që të përmbushen nga tenderuesit. Në pothuajse të gjitha pretendimet parashtruesi vetëm ka thënë se “këto kërkesa janë të panevojshme”. Në anën tjetër parashtruesi ka dorëzuar pretendime ankimore për shumicën e kërkesave mbi mundësitë teknike dhe profesionale. Kjo nënkupton që sipas parashtruesit shumica e kërkesave mbi mundësitë teknike dhe profesionale janë të panevojshme rrjedhimisht duhet të largohen ose të paktën të ndryshohen. Pra qysh në vështrim të përgjithshëm pretendimet e parashtruesit janë kundërthënëse dhe të palogjikshme për faktin se Autoriteti Kontraktues nuk mund të largoj shumicën e kërkesave mbi mundësitë teknike ose profesionale sikurse pretendon parashtruesi.

Përmes nenit 10 par. 10.1 nënparagrafi b) të RRPP është përcaktuar se njësia e kërkesës e cila ka inicuar aktivitetin e prokurimit ndër të tjera ka përgjegjësinë që të “Përgatit/proponon detyrën projektuese, projektin, specifikime teknike (ST), Termat e Referencës (TeR), dhe Paramasën dhe Paralogarinë”. Në rastin konkret njësia kërkuuese ka përgjegjësinë e plotë për paramasën sipas dosjes së tenderit të publikuar lidhur me aktivitetin përkatës të prokurimit.



Sa i përket pretendimeve ankimore me rastin e sigurimit të përgjigjes së cituar më sipër nga njëria kërkuese, zyrtari përgjegjës i prokurimit ka përmbushur përgjegjësitë e tij në kuptim të nenit 11 par. 11.3 nënpar. b) të RRPP ku përcaktohet se zyrtari i prokurimit “*në bashkëpunim me Udhëheqësit e Njësive kërkuese, koordinon të gjitha dokumentet, projektet, specifikimet, TeR, Paramasat dhe Parallojaritë dhe vizatimet*”.

Nga sa u tha më sipër, lidhur me pretendimet ankimore zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë përgjigjes së njësive kërkuese të cituar më lartë.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimi i parashtruesit është tërësisht i pabazuar. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 11.08.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.